



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR



Nr.1396(58339-01877-51-2020) regjistri
Datë 01.07.2020 regjistrimi

Nr.1282(3580) vendimi
Datë 29.09.2020 vendimi

VENDIM

“Ne emer te Republikës”
“Pushimin e çeshtjes”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder e perbere nga:

TONIN STERKAJ- GJYQTAR

dhe asistuar nga sekretare gjyqësore Florinda Gega, sot me datë 29.09.2020, në Shkoder, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me detyrë të mbyllura, çështjen penale me numer 1396(58339-01877-51-2020) regjistri themeltar, datë 01.07.2020 regjistrimi, që u përket paleve:

Kerkues: Prokuroria e Rrethit Shkoder, përfaqësuar nga Prokuror Xhevahir Lita, jo i pranishëm në seancë gjyqësore në momentin e shpalljes së vendimit.

I pandehuri: ~~Kasim Pjetri~~ Zoti biri i ~~Pjetri~~ F. datëlindjes 18.12.1965, lindur në Shkoder e banues në lagjen “Skenderbeg”, rruga “Canaj”, banesa me numer 32, qyteti Shkoder, bashkia Shkoder, me shtetësi shqiptare, me gjëndje civile beqar, me arsim 12 klase, me gjëndje gjyqësore i dënuar, jo i pranishëm në seancë gjyqësore, mbrojtur në gjykim nga avokat Bujar Hoti, anetarë i Dhomes së Avokatisë Shkoder, zgjedhur nga vete i pandehuri me akt të shkruar: prokurë të posaçme berë para noterit.

I akuzuar: Per kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

Objekti: Pushimin e procedimit penal numer 194 të vitit 2017, regjistruar me datë 12.02.2017 në Prokurorinë e Rrethit Shkoder ndaj shtetasit ~~Kasim Pjetri~~ Zoti akuzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

Baza Ligjore: Nenet 328/1, shkronja “b” dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale.

Trupi gjykues pasi, shqyrtoi çështjen në teresi, administroi provat si dhe degjoi bisedimet perfundimtare të:

Prokurorit i cili kerkoi:

Pranimin e kerkeses. Pushimin e procedimit penal numer 194 të vitit 2017, regjistruar me datë 12.02.2017 në Prokurorinë e Rrethit Shkoder ndaj shtetasit ~~Kasim Pjetri~~ Zoti akuzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

Avokatit mbrojtës të pandehurit i cili kerkoi:

Pranimin e kerkeses së Prokurorit. Pushimin e procedimit penal numer 194 të vitit 2017 të Prokurorisë së Rrethit Shkoder, regjistruar ndaj shtetasit ~~Kasim Pjetri~~ Zoti akuzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

VEREN SE

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder (*Gjykate kompetente sipas neneve 13/2/c,76 ,329/a e 329/b te Kodit te Procedures Penale*) eshte paraqitur per gjykim kerkesa e Prokurorise se Rrethit Shkoder,me objekt: Pushimin e procedimit penal numer 194 te vitit 2017,regjistruar me date 12.02.2017 ne Prokurorine e Rrethit Shkoder ndaj shtetasit ~~K...~~ ~~P...~~ ~~Z...~~ akuzuar per veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

Gjykimi i çeshtjes provoi se:

Me date 01.07.2020,Prokuroria e Rrethit Shkoder,ka paraqitur per gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Shkoder kerkesen penale me objekt:Pushimin e procedimit penal numer 194 te vitit 2017,regjistruar me date 12.02.2017 ne Prokurorine e Rrethit Shkoder ndaj shtetasit ~~K...~~ ~~P...~~ ~~Z...~~ akuzuar per veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”,veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

Ne zbatim te nenit 332 te Kodit te Procedures Penale,Gjykata me vendim te ndermjetem caktoi daten dhe oren per zhvillimine séances gjyqesore.

Ne séance gjyqesore u paraqiten Prokurori dhe avokati mbrojtes zgjedhur nga vetë i pandehuri.

Referuar materialit kallëzues,veprimeve procedurale te kryera gjate hetimit te çeshtjes dhe akteve te administruara ne fashikullin penal,rezulton se:

1.Me date 12.02.2017,Prokuroria e Rrethit Shkoder ka rregjistruar procedimin penal numer 194 te vitit 2017 per veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”parashikuara nga neni 287/1 i Kodit Penal dhe si person qe i atribuhet kjo veper penale eshte shenuar emri i shtetasit shqiptarë ~~K...~~ ~~P...~~ ~~Z...~~ datëlindjes 18.12.1965,lindur ne Shkoder e banues ne lagjen “Skenderbeg”,rruga “Canaj”,banesa private me numer 32,qyteti Shkoder,bashkia Shkoder.

2.Ky procedim penal eshte regjistruar per faktin se me date 29.11.2016,i pandehuri eshte arrestuar e me pas gjykuar e denuar per kryerjen e vepres penale “Trafikimi i narkotikëve”,mbetur në tentativë,parashikuar nga neni 283/a dhe 22 i Kodit Penal dhe me vendimin penal numer 73 date 25.06.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë vendim ky i lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda,Tiranë me vendimin numer 77,date 19.10.2018,ai është deklaruar fajtorë e denuar perfundimisht me 6 (gjashtë) vjet dhe 8 (tetë) muaj burgim per kryerjen e vepres penale “Trafikimi i narkotikëve”,mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a e 22 të Kodit Penal.

3.Ne kuader te procedimit penal numer 194 te vitit 2017,Prokuroria e Rrethit Shkoder ka kryer hetime dhe nga hetimet e kryera ka rezultuar se:

3.1.Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit rezulton se i pandehuri ~~K...~~ ~~Z...~~ me date 31.08.1994 është raportuar nga Policia e Ascoli-Piceno, Itali për kryerjen e veprës penale kundër personave; me date 22.12.1994 është raportuar nga policia e Barit, Itali për kryerjen e veprës penale të falsifikimit të dokumentave; me date 23.03.1995 është dënuar me anë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit nga Gjykata e Astit në Itali për kryerjen e veprës penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugorë dhe me date 05.06.2004 është hetuar nga Policia e Astit,në Itali për deklarim të rreme mbi identitetin e tij.

3.2.Sipas informacioneve të vëna në dispozicion nga bankat e nivelit të dytë që ushtrojnë veprimtarinë tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë rezulton se në llogarinë e te pandehurit ~~K...~~ ~~Z...~~ pranë Intesa San Paolo Bank janë transferuar shuma të mëdha parash nga shteti Italian,shuma të cilat ai i ka tërhequr



dorazi (cash). Konkretisht, në llogarinë me nr. 39095435101 (në monedhën euro) nga viti 2014 deri në vitin 2016 janë derdhur rreth 275 000 euro prej të cilave 212 900 euro janë tërhequr nga shtetasi Kaçjolin Zefi. Ky shtetas ka gjithashtu edhe llogarinë me nr. 39095435102 (në monedhën euro) hapur në vitin 2008 tek e cila ka transferuar nga llogaria e tij në bankën Intesa San Paola shumë prej 104 900 euro si dhe ka bërë derdhje dorazi (cash) shumë prej 57 475 euro. Nga kjo llogari rezulton të jetë transferuar një shumë prej 32 500 euro në llogarinë e shoqërisë "R.Cestaro" s.r.l me përshkrimin "për blerje automjeti", shumë të cilën e ka derdhur dorazi në të njëjtën ditë (datë 26 Maj 2016). Transfertat në llogaritë e shtetasit Kaçjolin Zefi janë bërë nga shteti Italian kryesisht nga shoqëria "Felix M" SRL por edhe nga shoqëri të tjera, përfshi dhe nga vetë shtetasi Kaçjolin Zefi dhe kanë përshkrime të ndryshme si psh: ndërtim kapanoni, transferim fondesh, kursime nga biznesi etj ndërsa tërheqjet e bëra nga shtetasi Kaçjolin Zefi kanë përshkrime të ndryshme si psh: tërheqje për nevoja familjare, tërheqje për kredinë, për pagesa ndërtimi, transferim tek llogaria tjetër etj. Ndërsa në emër të familjarëve të tij nuk rezultojnë transaksione me vlera të mëdha nga persona të dyshimtë brënda apo jashtë vëndit apo depozita bankare. Llogaritë e tyre bankare janë kryesisht llogari page, llogari aktive tek te cilat nuk është bërë asnjë veprim/transaksion, marrje kredie (me shuma relativista të vogla të cilat janë marre ndër vite dhe janë shlyer me këste brënda afatit të maturimit).

3.3. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga is-ZVRPP Shkodër rezulton se i pandehuri Kaçjolin Zefi nuk ka në pronësi të tij pasuri të paluajtshme të regjistruara por babai i tij shtetasi Pjetër Zefi, i datëlindjes 03.11.1929 ka në pronësi pasuritë si më poshtë vijon: pasurinë me numer 1/1/307, vol.21, fq.99, ZK 8593 "truall 53 m² + ndërtesë 10m²", pasurinë me numer 1/1/107+2-1, vol.21, fq.197, ZK 8593 "ndërtesë 100m²" të cilat janë blerë në datën 05.05.2005 me anë të kontratës shitblerje me nr.518/319 e janë blerë kundrejt vlerës prej 400 000 mije lekë dhe pasurinë me numer 10/64+1-3, vol.4, fq.201, ZK 8593 "apartament 78m² e cila është blerë në datën 03.02.1992 me anë të kontratës së shitblerjes nr. 14 /8, kundrejt vlerës prej 1 070 000 lekë.

3.4. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Zyra e ALUIZNI rezulton se shtetasi Pjetër Zefi (babai i te pandehurit) ka aplikuar në vitin 2006 për legalizimin e një objekti me sipërfaqe 279 m² prej të cilave 95m² ndërtim, ndodhur në lagjen "3 Heronjtë", Shkodër. Objekti është ndërtesë banimi me 2 kat, ndërtuar në vitin 1998, mbi pasurinë me nr. 10/517 për të cilën shtetasi Pjetër Zefi pas pranimit të kërkesës dhe kualifikimit të objektit për legalizim me anë të vendimit nr.2712 datë 22.04.2015, ka paguar shumë prej 198 000 në lekë dhe shumë prej 27 500 lek në bono thesari.

3.5. Sipas informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Shkodër dhe Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Shkodër rezulton se shtetasit Pjetër dhe Pjetër Zefi nuk kanë deklaruar/derdhur kontribute shoqërore dhe shëndetësore pranë organeve kompetente.

Ndërsa shtetasit Kaçjolin Zefi dhe Mardiana Zefi kanë derdhur kontribute si persona të punësuar pranë shoqërisë "Felix" shpk. Shtetasi Kaçjolin Zefi rezulton të ketë punuar që nga muaji gusht i vitit 2008 pranë shoqërisë "Felix M" shpk si shofer kamioni dhe për rrjedhojë ka hapur një llogari page me nr.39095435101 në të cilën përveç kreditimit të pages, e cila ka qënë fillimisht 15 000 lekë, më pas 20 000 lekë dhe së fundmi 30 000 lekë, janë depozituar edhe shuma të vogla parash prej atij vetë, shtetasës Vjehra Masi apo janë transferuar shuma të tilla në emër të motrës së tij Mardiana Zefi. Shtetasja Mardiana Zefi rezulton të ketë patur një pagë bruto prej 24 780-300 000 lekë /muaj.

Shoqëria "Felix M" shpk është regjistruar në vitin 1998 (në vitin 2007 ka blerë shoqërinë "Generale Made") e ka si objekt të veprimtarisë së saj prodhimin e konfeksioneve dhe ka tre ortakë: shtetsen Idriz Tefi e cila

zoteron 80% të kuotave, shtetasen ~~Mirëmbajtjes~~ ~~Z~~ e cila zoteron 10% të kuotave dhe shtetasen Kety ~~Mirëmbajtjes~~ e cila zoteron 10% të kuotave.

Shoqëria "Generale Made" shpk, në vitin 2002 është deklaruar pa aktivitet, në vitin 2003 ka deklaruar 54 200 lekë humbje, në vitin 2004 ka deklaruar 29 300 lekë humbje, në vitin 2005 është deklaruar pa aktivitet dhe në vitin 2006 është deklaruar pa aktivitet.

Ndërsa, shoqëria "Felix" shpk ka deklaruar ndër vite : në vitin 2002 0 lekë fitim, në vitin 2003 ka deklaruar 1 123 727 lekë fitim, në vitin 2004 ka deklaruar 3 086 429 lekë fitim, në vitin 2005 ka deklaruar 3 071 000 lekë fitim, në vitin 2006 ka deklaruar 3 537 125 lekë fitim, në vitin 2007 ka deklaruar 972 835 lekë fitim, në vitin 2008 ka deklaruar 849 511 lekë fitim, në vitin 2009 ka deklaruar 5 218 610 lekë fitim, në vitin 2010 ka deklaruar 5 526 333 lekë fitim, në vitin 2011 ka deklaruar 4 027 709 lekë fitim, në vitin 2012 ka deklaruar 4 552 819 lekë fitim, në vitin 2013 ka deklaruar 7 623 728 lekë fitim, në vitin 2014 ka deklaruar 6 135 325 lekë fitim, në vitin 2015 ka deklaruar 10 570 005 lekë fitim dhe në vitin 2016 ka deklaruar 5 958 128 lekë fitim. Aktualisht ka 637 000 lekë detyrim ndaj shtetit dhe 11 300 lekë të pa paguara (deri me datën 14.04.2017).

3.6. Shtetasi ~~Kajetan Z~~ ka regjistruar në vitin 2007 shoqërinë "Gersa-Z" shpk me NIPT K 7723100IQ me objekt "Fabrikim i sapunave, detergjentëve dhe produkteve të mirëmbajtjes", shoqëri e cila ka kaluar me status pasiv në vitin 2010. Ndër vite kjo shoqëri ka deklaruar këto fitime: në vitin 2007 humbje 129 052 lekë, në vitin 2008 ka deklaruar 406 441 lekë fitim, në vitin 2009 ka deklaruar 728 554 lekë fitim, në vitin 2010 ka deklaruar 258 022 lekë fitim, në vitin 2011 ka deklaruar 416 605 lekë fitim, në vitin 2012 ka deklaruar 48 125 lekë fitim, në vitin 2013 ka deklaruar 67 808 lekë fitim, në vitin 2014 ka deklaruar 207 060 lekë fitim dhe në vitin 2015 nuk ka deklaruar aktivitet.

3.7. Sipas informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor rezulton se i pandehuri ~~Kajetan Z~~ ka regjistruar mjete në këto Drejtori:

-me datë 20.01.2012 ka regjistruar mjetin e markës "Mercedes-Benz" me targa AA ~~980 CN~~, i cili është reregjistruar në mënyrë të përhershme në datë 19.05.2016;

-me datë 25.05.2013 ka regjistruar mjetin e markës "BMW" me targa AA ~~480 GP~~ (targa e mëparëshme AA ~~666 TO~~) të cilin e ka blerë nga shtetasi ~~Arin K~~ me anë të kontratës së shitjes nr.1039/597, datë 22.05.2013 kundrejt shumës prej 1 000 000 lekësh dhe më pas me anë të kontratës nr.4687/3033 datë 15.04.2015, ja ka shitur shtetasit ~~Kajetan Z~~ kundrejt shumës prej 500 000 lekësh (targa e re AA ~~666 TO~~).

-me datë 29.04.2015 ka regjistruar mjetin e markës "Porsche Panamera" me targa AA 201 LO të cilin e ka blerë nga shtetasi ~~Kajetan Z~~ me anë të kontratës nr.4686/3032 datë 15.04.2015 kundrejt shumës prej 10 000 euro (targa e mëparëshme AA ~~333 TL~~), ndërkohë që ky i fundit e ka blerë nga shtetasi ~~Fjodor~~ me anë të kontratës nr.71/46 datë 04.01.2014 kundrejt shumës prej 1 000 000 lekë ndërsa vetë shtetasi ~~Fjodor~~ e ka blerë një vit më përpara (në vitin 2013) kundrejt shumës prej 41 600 euro.

-me datë 25.08.2014 ka regjistruar mjetin e markës "Fiat Ducato" me targa AA ~~640 P~~ të cilin e ka blerë nga shtetasi ~~Arin K~~ në shtetin Italian kundrejt shumës prej 500 euro dhe një vit më vonë ia ka shitur shtetasit ~~Arin K~~ me anë të kontratës nr.232/166 datë 24.01.2015 kundrejt shumës prej 250 000 lekësh.

-me datë 03.06.2014 ka regjistruar mjetin e markës "Land Rover-Free Lander" me targa AA ~~630 EY~~, të cilin e ka blerë nga shtetasi italian ~~Mario Sampanesi~~ kundrejt shumës prej 900 euro.

-me datë 30.07.2015 ka regjistruar mjetin e markes "Peugot" me targa AA 97, të cilin e ka blerë nga shtetasi [redacted] me anë të kontratës së shitjes nr.4104/2844 datë 27.07.2015 kundrejt shumës prej 200 000 lekësh ndërkohë që ky i fundit e ka blerë në të njëjtin vit kundrejt shumës prej 9500 euro.

-me datë 12.07.2017 ka regjistruar mjetin e markës "Ferrari California" me targa AA [redacted] të cilën e ka blerë në Itali kundrejt shumës prej 32 500 euro.

Aktualisht në pronësi të shtetasit [redacted] rezultojnë automjetet me targa AA 201, AA [redacted] (Ky automjet me anë të kontratës së shitjes nr.3811/2100 date 04.07.2017 ka kaluar në pronësi të shtetasit Françesk Shllaku), AA [redacted] dhe AA [redacted] OA, pasi automjetet e tjera rezultojnë të kenë kaluar në pronësi të shtetasit [redacted] ndërkohë që shtetasi [redacted] ka qënë nën masën e sigurimit "Arrest me burg".

Sipas organit të akuzës, çmimet me të cilat janë shitur këto automjete është shumë i ulët në krahasim me çmimin e blerjes dhe atë të vlerësuar nga ekspertët, ndërkohë që shtetasi [redacted] nga verifikimet dhe hetimet e kryera siguron dhe ka siguruar ndër vite të ardhura minimale. Sipas deklarimeve të tij shtetasi [redacted] pandehuri [redacted] kishte lek borxh dhe meqë nuk kishte tja kthente i ka shitur automjetet nën vlerën e tyre reale. Këto automjete janë blerë me kursimet e tij ndër vite dhe diferencën që ka rezultuar nga borxhi ia ka dhënë shtetasës [redacted] (bashkëjetueses së shtetasit [redacted]).

Ndërsa familjarët e tij nuk kanë patur apo kanë automjetë të regjistruara në pronësi të tyre përveç motrës së tij [redacted] e cila ka të regjistruar automjetin me targa SH [redacted] i markës [redacted] blerë kundrejt shumës prej 500 000 lekësh me anë të kontratës së shitjes nr.5651/4484 datë 09 .09.2009.

4.Gjate hetimit të çështjes është pyete në cilësinë e personi të ka dijani për veprën penale shtetasja [redacted] e cila ka deklaruar se paratë janë transferuar prej saj në llogarinë personale të shtetasit [redacted] për llogari të shoqërisë "Felix M" shpk me qëllim blerjen e kaponit apo kryerjen e pagesave të ndryshme.

Sipas organit të akuzës ky deklarim ishte në kundërshtim me provat e administruara sipas të cilave rezultoi se vetë shoqëria "Felix M" shpk ka patur 3 llogari bankare të hapura në emrin e saj, tërheqjet e bëra nga shtetasi [redacted] (sipas deklarimeve të bëra prej tij në bankë) kanë qënë për "nevoja familjare" etj si dhe një pjesë e madhe e parave të derdhura në llogarinë e te pandehurit [redacted] janë transferuar prej tij në një tjetër llogari bankare po në emrin e tij dhe janë përdorur për shpenzime të ndryshme si psh: blerje automjeti etj.

5.Gjate hetimit të çështjes është pyetur në cilësinë e personi të ka dijani për veprën penale shtetasja [redacted] e cila ka deklaruar se me shtetasin [redacted] kanë qënë të lidhur prej vitesh dhe nga lidhja e tyre kanë lindur edhe dy fëmijë. Aktualisht punon në profesionin e saj si parukjere por më përpara është marrë me tregti. Ka deklaruar se nga shitja e automjeteve nga shtetasi [redacted] ajo ka marrë një shumë prej 2500 euro të cilat ka shkuar i ka marrë në Durrës tek një shtetas me emrin [redacted] të cilin ishte hera e parë që e takonte.

6.Gjate hetimit të çështjes është pyetur në cilësinë e personi të ka dijani për veprën penale shtetasja [redacted] e cila ka deklaruar se vëllai i saj është i punësuar tek shoqëria "Felix M" shpk ku ajo zotëron 10% të kapitalit me një pagë mujore prej 30 000 lekë. Në vitin 2014 të dy së bashku kanë marrë një kredi prej 1 000 000 lekë për biznes tek banka Intesa San Paolo ndërsa në vitin 2016 ajo ka marrë një kredi tjetër në të njëjtën bankë dhe në të njëjtën shumë për blerjen e një automjeti të markes "Benz A- Class".

7.Gjate hetimeve paraprake nga ana e organit të akuzës duke qënë se disponimi i lirë i pasurive të fituara në mënyrë të kundraligjshme mund të rëndonte ose të zgjaste pasojat e veprës penale ose të lehtësonte kryerjen e veprave penale të tjera pasi këto pasuri mund të ishin objekt material i transaksioneve të ndryshme juridike

nga të cilat mund të cënohen interesat ligjor të shtetasve ose personave juridik blerës potencial të këtyre pronave të mbrojtura nga ligji penal apo ligjet e tjera në bazë të neneve 274 dhe 275 të Kodit të Procedurës Penale është kërkuar vendosja e sekuestros preventive mbi pasuritë e luajtshme dhe të pa luajtshme të regjistruara në emër të pandehurit ~~Kajdullu Zefi~~ dhe shtetasit ~~Petar Zefi~~. Kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Shkodër dhe Vendimi i saj numer 825 datë 22.09.2017 është përcjellë për ekzekutim pranë organeve kompetente.

8. Gjate hetimit të çështjes janë kryer akte vlersimi e akte kontabel.

8.1. Sipas aktit të ekspertimit vlerësues-mjeti rezulton se:

- vlera e tregut e mjetit të markes "Porsche Panamera", vit prodhimi 2012, me targa AA ~~973 LZ~~ në para në momentin e vlerësimit është 4 860 800 lekë (*katër milion e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind lekë*)

- vlera e tregut e mjetit të markes "Peugeot 407", viti i prodhimit 2007, me targa AA ~~973 LZ~~ në para në momentin e vlerësimit ka qënë 248.000 lekë (*dyqind e dyzet e tetë mijë lekë*).

- vlera e tregut e mjetit të markes "Ferrari California", viti i prodhimit 2012, me targa AA ~~973 LZ~~ në para është 11 147 600 lekë (*njëmbëdhjetë milion e njëqind e shtatë mijë e gjashtëqind lekë*).

- vlera e tregut të mjetit të markes "Land Rover, Free Lander", vit prodhimi 2005, me targa AA ~~973 LZ~~ në para është 396.800 lekë (*treqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë lekë*).

9. Sipas aktit të ekspertimit kontabël të detajuar rezulton se:

- Vlera totale e paguar nga shtetasi ~~Petar Zefi~~ për pronat e paluajtshme, referuar kontratave të shitblerjeve në momentin e shitblerjeve, për vitet 1999-2017, është në vlerën totale 1.470.000 lekë (*një milion e katërqind e shtatëdhjetë mijë*);

- Vlera e paguar me Urdhërxhirimin e CREDINS Bank, nr. 000061015147, dt 21.08.2015, për pagesën e taksës së parcelës ndërtimore prej zj. ~~Arata Kropiku~~ për llogari të ~~Petar Zefi~~, është në vlerën 198.000 në favor të ALUIZNI-t.

- Vlera totale e bonove të privatizimit, e paraqitur si shlyerje e detyrimeve ndaj ALUIZNI-t, por e pa dokumentuar me dokumente që vërtetojnë përdorimin e tyre, është në vlerën e 275.000 lekë (*dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë*).

- Vlera totale e pasurive të paluajtshme për shtetasin ~~Petar Zefi~~ për pronat e paluajtshme, referuar kontratave të shitblerjeve në momentin e shitblerjeve është në vlerën totale 1.943.000 lekë (*një milion e nëntëqind e dyzet e tri mijë*).

- Shtetasi ~~Kajdullu Zefi~~ dhe familjarët e tij, nuk rezultojnë të kenë të regjistruar në pronësi të tyre pasuri të paluajtshme.

Shtetasi ~~Kajdullu Zefi~~, sipas analizës dhe paraqitjes së veprimeve të shitblerjeve të automjeteve rezulton që ka në përdorim vetëm automjetin e markes "Peugeot 407", vit prodhimi 2007, me targë shtetërore AA ~~973 LZ~~. Vlera e automjetit të markes "Peugeot 407", vit prodhimi 2007, me targë shtetërore AA ~~973 LZ~~, sipas kontratës së shitblerjes me nr. rep. 4104, nr. koi. 2844, datë 27.07.2015, bere para noteres ~~Valbona Hajdari~~ Shkodër, është në vlerën 200,000 lekë (*dyqind mijë*) ndërsa sipas akt-vlerësimit të ekspertëve të licencuar, në dhjetor 2018 është 248.000 lekë (*dyqind e dyzet e tetë mijë*).

Të ardhurat totale të ligjshme të deklaruara nga i pandehuri ~~Kajdullu Zefi~~ (tabela 44) janë në vlerën 4.078.353,84 lekë (*katër milion e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e pesëdhjetë e tre e tetëdhjetë e kater*)lek të ndara si më poshtë:



a. Të ardhurat e raportuara si paga bruto në organet fiskale për ~~Karajin Zef~~ për periudhën 01.03.2012-31.01.2017, rezultojnë në vlerën 1.572.520 lekë (një milion e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëqind e njëzet). V.O: Listëpagesat në sistemin c@ts fillojnë nga 01.03.2012, prandaj dhe llogaritja e pagave bruto është nga kjo datë; Listëpagesat në sistemin c@ts janë deri me 31.01.2017, ndërsa xhirimet e pagave deri me 31.03.2017, në vlerën neto të tyre për këtë periudhë janë në vlerën 1.432.064 lekë (një milion e katërqind e tridhjetë e dy mijë e gjashtëdhjetë e katër) lek.

a/1. Të ardhurat e realizuara nga ~~Karajin Zef~~ prej shitjeve të mjeteve motorrike, sipas kontratave noteriale rezultojnë në vlerën 2.503.645 lekë (dy milion e pesëqind e tri mijë e gjashtëqind e dyzet e pesë);

a/2. Të ardhurat e realizuara nga ~~Karajin Zef~~ nga interesat bankare për vitet 2007-2017 janë në vlerën 2.188.84 lekë (dy mijë e njëqind e tetëdhjetë e tetë 84/100).

b. Të ardhurat totale të ligjshme të deklaruara nga ~~Mirusha Zef~~ (tabela 45), janë në vlerën 1.408.571,42 lekë (një milion e katërqind e tetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e një e dyzet e dy) lek të ndara si më poshtë:

b/1. Të ardhurat e raportuara si paga bruto për periudhën 01.06.2013-deri me 31.07.2013 janë në vlerën 1.400.820 lekë (një milion e katërqind mijë e tetëqind e njëzet) lek. V.O: Listëpagesat në sistemin c@ts fillojnë nga data 01.06.2013 dhe llogaritjet e të ardhurave fillojnë nga kjo datë; Listëpagesat në sistemin c@ts janë deri me 31.07.2017, ndërsa xhirimet e pagave deri me 31.03.2017, në vlerën neto të tyre për këtë periudhë janë në shumën 1,226,395 lekë (një milion e dyqind e njëzei e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë).

b/2. Të ardhurat e realizuara nga ~~Mirusha Zef~~ nga interesat bankare për vitet 2007-2017 janë në vlerën 7.751,42 lekë (shtatë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e një e dyzet e dy) lek.

c. Nuk raportohen të ardhura të përfituara nga shpërndarjet e dividendëve nga fitimet e kompanive "Felix M" dhe "Gersa-Z" SHPK.

Krahasimin e të ardhurave të ligjshme të shtetasit ~~Karajin Zef~~ dhe familjarëve të tij me vlerat e pronave të blera, e jep tabela nr.46.

Për vitet 1999-2007, nuk ka asnjë informacion zyrtar që vërteton të ardhurat e realizuara prej kryefamiljarit ~~Djuro Zef~~ dhe anëtarëve të tjerë të familjes së tij. Nga vlera e pasurive të paluajtshme prej 2.020.000 lekë, janë paguar cash 1.668.000 lekë, ndërsa për vlerën e mbetur për 275.000 lekë janë përdorur bonot e privatizimit për shlyerje detyrimi ndaj ALUIZNI-t.

Në mungesë të informacioneve më të plota për të ardhurat e ligjshme familiare të realizuara prej tyre ndër vite, rezultati del me deficit të ardhurash në vlerën 5.979.774.74 lekë (pesë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër) lek.

Nga ~~Karajin Zef~~, është marrë kredi në vlerën 1,000,000 lekë (një milion) më date 16.12.2011 nga ISP, ndërsa nga ~~Mirusha Zef~~ janë marrë dy kredi, njëra në vitin 2012 për 1,000,000 (një milion) lekë dhe tjetra në vitin 2016 për 400,000 (katërqind mijë) lekë.

Meqenese i pandehuri ~~Karajin Zef~~ është deklaruar fajtor e i denuar me burgim për veprën penale "Trafikimi i nakotikëve", kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë parashikuar nga nenet 283/a/2, 22 dhe 23 të Kodit Penal, duke marrë shkas nga ky fakt, ndaj tij dhe familjarët e tij, organi i akuzës ka kryer një hetim të thelluar pasuror dhe në përfundim të të cilit, sipas organit të akuzës ka rezultuar se pasuria e zotëruar nga i pandehuri ~~Karajin Zef~~ nuk justifikohet me të ardhurat e ligjshme të tij dhe të familjarëve të tij.

Organi i akuzes,bazuar ne te dhenat e grumbulluara gjate hetimit te çeshtjes dhe bazuar ne konkluzionei akteve te ekspertimit "Vlersues-Kontrabel",ka arrite në konkluzionin se pasurite e te pandehurit janë përfitur (janë produkt i veprës penale) për të cilën ky i pandehur është dënuar.

Sipas Prokurorit,të ardhurat e përfituara janë invenstuar më pas kryesisht në pasuri të pa luajtshme por edhe të luajtshme.

Organi i akuzes ka vlersuar se plotësohen të tre kushtet kumulative të parashikuara nga neni 287 i Kodit Penal e per rrjedhoje i pandehuri ~~XXXXXXXXXX~~ ka përgjegjësi për konsumimin e veprës penale të "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale",parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

10.Me date 28.05.2019,Prokuroria e Rrethit Shkoder me kerkese drejtuar Gjyktes se Rrethit Gjyqesor Shkoder ka kerkuar:Dergimin ne gjyq procedimin penal numer 194 te vitit 2017 te Prokurorise se Rrethit Shkoder,regjistruar ndaj te pandehurit,shtetasit shqiptarë ~~XXXXXXXXXX~~,i akuzuar per kryerjen e vepres penale"Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale",parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal .

11.Gjykata e Rrethit Gjyqesor Shkoder pasi ka shqyrtuar çeshtjen,me vendimin e saj numer 1943(5705), date 11.11.2019 ka vendosur:

1.Mos pranimin e kërkesës së Prokurorisë se Rrethit Gjyqesor Shkoder.

2.Kthimin e akteve te procedimit penal numer 194 te vitit 2017 te Prokurorise se Rrethit Shkoder,me te pandehur shtetasin shqiptarë Kaçjolin Pjeter Zefi,i akuzuar per kryerjen e vepres penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale",parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal,ne Prokurorine e Rrethit Shkoder per te kryer veprime te metejshme e konkretisht per të riberë aktet e ekspertimit "Kontabel" e "Vlersues",akte ekspertimi te cilat duhet te ribëhen duke respektuar kerkesat ligjore te neneve 34/a/1 shkronjat "ë","f" e "g";50/2 dhe 179 te Kodit te Procedures Penale.

Ndaj ketij vendim nuk eshte ushtruar ankim e per rrjedhoje ka marre forme te prerë.

Ne vendimin e saj,Gjykata ka evidentuar faktet se:

Akuza e ngritur ndaj te pandehurit eshte bazuar ne konkluzionet e aktet e ekspertimit "Kontabel" e "Vlersues",datë 02.10.2018 dhe datë 22.12.2018 dhe se keto akte jane bazuar kryesisht ne te dhenat e vena ne dispozicion te hetimit nga organet kompetente.

Nga provat e paraqitura eshte provuar se vendimi i organit procedues(Prokurorise) për caktimin e ekspertin nuk i ishte njoftuar të pandehurit ose mbrojtësit të tij.Te pandehurit dhe mbrojtësit te tij nuk u ishin berë të ditur se ata kane të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit,të propozojnë ekspertë të tjerë,të marrin pjesë vetë në ekspertim,ku është e mundur dhe të parashtrojmë pyetje për ekspertin.

Gjykata ka vlersuar se ky veprim i Prokurorit kishte cenuar te drejtat e te pandehurit,te drejta keto te parashikuara ne nenin 34/a/1 shkronjat "ë","f" e "g" te Kodit te Procedures Penale.Ne rastin konkret te pandehurit i ishte mohuar e drejta të njihet me materialet e çeshtjes,sipas parashikimeve të këtij Kodi,të paraqesë prova që i shërbejnë mbrojtjes së tij dhe t'u bëjë pyetje ekspertëve.

Gjykata ka vlersuar se ky veprim i Prokurorit kishte cenuar dhe te drejtat e te pandehurit te shtrira tek mbrojtësi,pasi provohej se i pandehuri kishte mbrojtës,fakt ky i njohur dhe nga Prokurori,por dhe mbrojtësit i ishin shkeluar te drejtat e parashikuara ne nenin 50/2 te Kodit te Procedures Penale.Edhe mbrojtësi i te pandehurit megjithese kishte te drejte të njoftohej paraprakisht për kryerjen e veprimeve hetimore ku ishte i pranishëm i pandehuri dhe të merrte pjesë në to,t'u drejtonte pyetje ekspertëve e të njihej me të gjithë materialin e çeshtjes në përfundim të hetimeve,i ishte mohuar kjo e drejtë.

I pandehuri e mbrojtësi i tij ishin njohur me akuzen dhe provat me datë 10.05.2019,datë ne te cilen shtetasi ~~XXXXXXXXXX~~ eshte pyetur me cilesine e te pandehurit i eshte komunikuar akuza.



Brenda afatit ligjorë(10 ditë),me date 20.05.2019,mbrojtesi i te pandehurit ,me memorie drejtuar Prokurorit te çeshtjes,kishte kerkuar qe te riparohen shkeljet e konstatuara gjate hetimit te çeshtjes(kryesisht te akteve te ekspertimit kontabel dhe aktit te ekspertimit vlersues) dhe kishte kerkuar qe te paraqes prova.

Me shkresen me numer 478/1 prot date 11.06.2019 te titulluar "Kthim pergjigje" drejtuar mbrojtetit te pandehurit,organi procedues nuk ka vlersuar pretendimet e ngritura nga mbrojtesi e i pandehuri por u eshte pergjigjur: *"Procedimi penal nr 194/2017 ndodhet ne fazen e shqyrtimit nga gjyqtari i seances paraprake. ndodhur ne keto kushte, per cdo kerkese qe mund te keni ne kuader apo dobi te te ketij procedimi penal ju duhet ti drejtoheni ketij te fundit ne perputhje me rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedures Penale"*.

Bazuar ne faktet e mesiperme,Gjykata bazuar ne nenin 130/4 te K Pr Penale,sipas te cilit "Gjate hetimeve paraprake çmuarja e pavlefshmërisë bëhet nga prokurori dhe nëse nuk kryhet nga ky i fundit,çmohet nga gjyqtari i seancës paraprake",ka vlersuar se aktet e ekspertimit "Kontabel-Vlersues",date 02.10.2018 dhe 22.12.2018,mbi te cilat dhe ishte bazuar akuza ndaj te pandehurit,duheshin deklaruar te pavlefshme dhe bazuar ne nenin 131/1 te Kodit te Procedures Penale,me titull "Pasojat e deklarimit të pavlefshmërisë", sipas te cilit:"Pavlefshmëria e një akti i bën të pavlefshme aktet e mëpasme që varen nga ai që është deklaruar i pavlefshëm" dhe nenin 131/2 te Kodit te Procedures Penale,ka urdheruar perscritjen e ketyre akteve.

Ne funksion te nje hetimi sa me te plotë e shterues,Gjykata,bazuar ne nenin 131/2 te Kodit te Procedures Penale,ka urdheruar organin procedues (Prokurorine e Rrethit Shkoder) qe te ribejë aktet e ekspertimit "Kontabel" dhe "Vlersues"per llogari te ketij procedimi penal,pasi ekspertimet "Kontabel" e "Vlersues", jane te nevojshme dhe mund te realizohen.

Gjykata ka theksuar faktin se ne riberjen e akteve te ekspertimit "Kontabel" e "Vlersues",nga ana e organit procedues duhet te respektohen percaktimet ligjore te parashikuara nga:neni 34/a/1 shkronjat "ë","f" e "g",nga neni 50/2 dhe nga neni 179/2 te Kodit te Procedures Penale.

Ne caktimin e ekspertit/ekspertëve,organi procedues te garantoje te drejtat e te pandehurit,i cili ka të drejtë të kërkojë përjashtimin e ekspertit,të propozojnë ekspertë të tjerë dhe të parashtrijmë pyetje për ekspertin.

Ti garantoje te pandehurit dhe mbrojtetit te tij te njihet me materialet e çeshtjes,sipas parashikimeve të ketij Kodi,të paraqesin prova nese kanë e që i shërbejnë mbrojtjes së tij.

Ne vendimin e saj,Gjykata ka sjellë në vemendjen e Prokurorit faktin se bazuar ne nenin 10/2 te ligjit numer 10192,date 03.12.2009 "Per parandalimin e goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë",nese gjate hetimit te çeshtjes lind nevoja per te vertetuar ligjshmerine e provave te paraqitura nga i pandehuri e lind nevoja për ndihmë juridike ndërkombëtare,zbatohen marrëveshjet ndërkombëtare të pranuar nga shteti shqiptar si dhe dispozitat respektive procedurale (leterporositë per jashte shteti).

Per shkaqet e mesiperme,Gjykata bazuar ne nenin 332/ç/1 te te Kodit te Procedures Penale ka vendose te mos pranoje kerkesen e Prokurorise se Rrethit Shkoder per "Dergimin ne gjyq procedimin penal numer 194 te vitit 2017 te Prokurorise se Rrethit Shkoder,me te pandehur shtetasin shqiptarë ~~Kasim P. Z.~~ akuzuar per kryerjen e vepres penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal dhe ka vendose qe ky procedim penal te kthehet ne Prokurorine e Rrethit Shkoder per vazhdimin e hetimeve dhe konkretisht per të riberë aktet e ekspertimit "Kontabel" e "Vlersues",akte ekspertimi te cilat duhej te ribësheshin duke respektuar kerkesat ligjore te neneve 34/a/1 shkronjat "ë","f" e "g";50/2 dhe 179 te Kodit te Procedures Penale.

Gjykata ka vlersuar se vetëm pas kryerjes së të gjitha veprimeve të përmenduar më lart mund të konkludohet në një përfundim të drejtë, lidhur me çështjen në fjalë, nëse shtetasi ~~K. P. Z.~~ mund të akuzohet ose jo për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

12. Në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësorë Shkoder me vendimin e saj numer 1943(5705), datë 11.11.2019, Prokuroria e rrethit Shkoder ka zhvilluar hetime e ka grumbulluar prova dhe në përfundim të hetimeve të zhvilluara ka arritur në përfundimin se:

Gjatë hetimit të çështjes, shtetasi ~~K. P. Z.~~ ka paraqitur prova në formën e kërkuar nga ligji, me anën e të cilave provohet se ai nga vitet 1991 deri në vitin 2013 ka jetuar e punuar në Itali, se gjatë kësaj periudhe ka siguruar të ardhura, se gjatë kësaj periudhe i ka deklaruar para autoriteteve italiane keto të ardhura, se ka siguruar kontribut zyrtar të ardhurash në këto shtet shumen prej 46.645 euro, se për gjatë katër viteve ai është strehuar në banesën e shtetases italiane ~~K. M.~~ e cila i ka marrë persiper, pa pagesë strehimin e ushqimin.

Prokuroria e ka arritur në konkluzionin se të ardhurat dhe pasuritë e luajtshme e të paluajtshme që figurojnë në emër të pandehurit dhe personave të tjerë të lidhur me të, janë krijuar në një mënyrë të ligjshme e nuk janë krijuar si rezultat i pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, për të cilin pandehuri është deklaruar fajtorë e denuar me burgim, me vendimin penal numer 73 datë 25.06.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë me vendimin numer 77, datë 19.10.2018 me të cilin ai është deklaruar fajtor e denuar përfundimisht me 6 (gjashtë) vjet dhe 8 (tetë) muaj burgim për kryerjen e veprës penale "Trafikimi i narkotikëve", mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.

13. Me datë 05.02.2020, Prokuroria e Rrethit Shkoder, bazuar në nenet 328/1, shkronja "b" dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale, me kërkesë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkoder, ka kërkuar: Pushimin e procedimit penal numer 194 të vitit 2017, regjistruar me datë 12.02.2017 në Prokurorinë e Rrethit Shkoder ndaj shtetasis ~~K. P. Z.~~ akuzuar për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", veprën kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal, me pretendimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale.

14. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkoder, pasi ka shqyrtuar kërkesën e Prokurorit, me vendimin penal numer 523(1417) datë 07.05.2020 ndër të tjera ka vendosur:

"Mos pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkoder për pushimin e hetimeve të procedimit penal numer 194 të vitit 2017 të Prokurorisë së Rrethit Shkoder, regjistruar ndaj të pandehurit, shtetasis shqiptarë ~~K. P. Z.~~ akuzuar për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.

-Kthimin e akteve të procedimit penal numer 194 të vitit 2017 të Prokurorisë së Rrethit Shkoder, me të pandehur shtetasin shqiptarë ~~K. P. Z.~~ akuzuar për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal, në Prokurorinë e Rrethit Shkoder për të kryer veprime të metejshme e konkretisht për të ribërë aktet e ekspertimit "Kontabel" e "Vlersues", akte ekspertimi të cilat duhet të ribëhen duke respektuar kërkesat ligjore të parashikuara në nenet 34/a/1 shkronjat "ë", "f" e "g"; 50/2 dhe 179 të Kodit të Procedurës Penale.

-Për kryerjen e katër akteve, Prokurorit i lihet një afat prej 30 ditë, afat që fillon nga nesërmeja e shpalljes e këtij vendimi.



-Kunder ketij vendimi lejohet ankimi brenda 15 diteve,duke filluar nga e nesermja e shpalljes,ne Gjykatën e Apelit Shkoder”.

Ndaj ketij vendim nuk eshte paraqite ankim e per ketë arsye ka marre formë te prerë me date 17.06.2020.

15.Ne zbatim te detyrave te lena nga Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Shkoder me vendimin e saj numer 523(1417),datë 07.05.2020,Prokuroria e rrethit Shkoder ka zhvilluar hetime,ka urdheruar e ka kryer ekspertimet “Kontabel” e “Vlersues”,ka grumbulluar prova dhe ne perfundim te hetimeve te zhvilluara ka arritë ne perfundimin se:Nga aktet e ekspertimeve kontabel e vlersues,rezulton se pasuria e shtetasit Kaçjolin Zefi mbulohet nga te ardhura te ligjeshme.Nga hetimet e zhvilluara nuk konstatohen elementet e figures se vepres penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”,parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal.Nuk provohet ekzistenca e nje vepre penale qe gjeneron te ardhura.

16.Me date 01.07.2020,Prokuroria e Rrethit Shkoder,bazuar në nenet 328/1,shkronja “b” dhe 329/a te Kodit te Procedures Penale,me kerkesë drejtuar perseri Gjykates se Rrethit Gjyqesor Shkoder,kerkon:Pushimin e procedimit penal numer 194 te vitit 2017,regjistruar me datë 12.02.2017 ne Prokurorine e Rrethit Shkoder ndaj shtetasit ~~K. P. Z.~~ akuzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”,veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal,me pretendimin se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepre penale.

Në lidhje me kerkesen e paraqitur trupi gjykues arsyeton se:

Kerkesa e Prokurorit per pushimin e procedimit penal numër 194 te vitit 2017,regjistruar me datë 12.02.2017 ne Prokurorine e Rrethit Shkoder ndaj shtetasit ~~K. P. Z.~~ akuzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”,veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal,eshte e drejte e bazuar ne ligj,ne nenin 329/1 te Kodit te Procedures Penale,nen i cili parashikon:

Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.

Referuar provave te marra e te shqyrtuara ne kete gjykim provohet se:

1.Procedimi penal numer 194 i vitit 2017,i regjistruar ne Prokurorine e Rrethit Shkoder i referohet faktit se i pandehuri i ketij procedimi penal,shtetasi shqiptarë ~~K. P. Z.~~ me vendimin penal te formes se prerë numer 73 datë 25.06.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda,eshte deklaruar fajtor e denuar 6(gjashtë) vjet dhe 8 (tetë) muaj burgim per kryerjen e vepres penale “Trafikimi i narkotikëve”,mbetur në tentativë,parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 te Kodit Penal.

Ka patur dyshime te arsyeshme se pasuria e zotëruar nga i pandehuri ~~K. P. Z.~~ dhe te afermit e tij,nuk justifikohet me të ardhurat e ligjshme të tij dhe të familjarëve të tij,pasurite e te pandehurit janë përfituar (janë produkt i veprës penale) për të cilën ky i pandehur është denuar dhe të ardhurat e përfituara janë invenstuar më pas kryesisht në pasuri të pa luajtshme por edhe të luajtshme.

I pandehuri e familjarët apo të afërmit e tij disponojë pasuri të luajtshme apo të pa luajtshme,per të cilat dyshohet se nuk justifikohen nga të ardhurat e tij të cilat janë përfituar duke kryer një punë apo veprimtari të ligjshme.Ka dyshime te arsyeshme se të ardhurat e përfituara nga kryerja e veprimtarive të jashteligjshme janë përdorur apo përdoren në/për veprimtari të ligjshme me qëllim fshehjen e origjinës së tyre.

Provohet se organi i akuzës në funksion të një hetimi të plotë dhe objektiv,me qëllim zbardhjen e çështjes konkrete,ka administruar prova në përputhje me rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Penale.

Ka verifikuar te gjitha pasurite e luajteshem e te palujteshme te regjistruara ne favor te pandehurit dhe familjarve te tij, transaksionet bankare, shitjet e pasurive dhe te ardhurat e perfituara nga shitje etj. Me pas me vendim te organit procedues jane kryer aktet e ekspertimit "Vlersues" e "Kontabel". Per llogari te ketij procedimi penal jane kryer dy akte ekspertimi: ekspertimi "Kontabel" dhe ekspertimi "Vlersues", njëri me datë 02.10.2018 dhe tjetri me 22.12.2018. Ne formulimin e akuzes ndaj te pandehurit, organi i akuzes eshte mbeshtetur pikerisht ne konkluzionet e akteve te ekspertimit "Kontabel" e "Vlersues", te datave 02.10.2018 dhe 22.12.2018.

2. Procedimi penal numër 194 i vitit 2017, eshte regjistruar ne Prokurorine e Rrethit Shkoder për veprën penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal, i cili parashikon:

Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

- a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;
- d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale;
- dh) këshillimit, ndihmës, nxitjes ose thirrjes publike për kryerjen e secilës prej veprave të përcaktuara më sipër;

Kur kjo veprë kryhet gjatë ushtrimit të një veprimtarie profesionale, në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim ngashtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

E njëjta veprë, kur ka sjellë pasojë të rënda, dënohet jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet me burgim.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe kur:

- a) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person që nuk mund të merret si i pandehur ose që nuk mund të dënohet;
- b) ndjekja penale për veprën, produktet e së cilës pastrohen, është parashikuar ose amnistuar;
- c) personi që kryen pastrimin e produkteve është i njëjtë me personin që ka kryer veprën, nga e cila kanë rrjedhur produktet;
- ç) për veprën penale, nga e cila kanë ardhur produktet, nuk është filluar asnjëherë çështja penale apo nuk është dhënë një dënim me vendim penal të formës së prerë;
- d) vepra penale, produktet e së cilës pastrohen, është kryer nga një person, pavarësisht shtetësisë së tij, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe është njëkohësisht e dënuar me një dënim në shtetin e huaj, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë. Dijenja dhe qëllimi, sipas paragrafit të parë të këtij neni, nxirren nga rrethana jakti objekti.

Për të patur një veper penale është e domosdoshme te provohet ekzistenca e fakteve, rrethanave, veprimeve apo mosveprimeve ne kundërshtim me ligjin, te kryera nga çdo person i pergjegjshem dhe qe ka mbushe moshen per pergjegjesi penale.

Eshtë e domosdoshme dhe duhet te provohet ekzistenca e lidhjes shkaksore dhe ekzistenca e fajit (nenet 13 e 14 te Kodit Penal).

Ndërsa per të patur një figurë konkrete të veprës penale është e domosdoshme ekzistenca e të gjithë elementëve përbërës të saj të marra së bashku, të cilët janë: a) objekti i veprës penale; b) ana objektive; c) subjekti dhe ç) ana subjektive.



Provueshmëria e elementëve objektive dhe subjektive të figurës së veprës penale, shërben si bazë për të vënë një person përpara përgjegjësisë penale. Gjithashtu, vepra penale paraqet në vetvete një unitet të të gjithë elementëve të figurës së saj. Ajo konsiderohet e kryer në mënyrë të plotë atëherë kur ekzistojnë të katër elementët e saj: objekti, ana objektive, subjekti dhe ana subjektive. Nëse mungon njëri prej këtyre elementëve, vepra penale nuk ekziston.

Prandaj, në çështjen konkrete, gjykata, duhet të shohë e të verifikojë, ekzistencën e të gjithë elementëve të veprës penale dhe të figurës së saj në veçanti.

Objekti i veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale", parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar garantimin e funksionimit të rregullt të organeve të administratës publike dhe mbrojtjen e interesit të shtetit dhe shtetasve nga pastrimi i produkteve të veprës penale. Ndërsa, objekti material përfaqëson vetë produktin e veprës penale që "pastrohet".

Nga ana objektive kjo veprë penale kryhet me veprime të kundraligjshme në mënyra të ndryshme si psh: nëpërmjet këmbimit ose transferimit të pasurisë që dihet se është produkt i veprës penale, fshehjes ose mbulimit të natyrës, burimit, vendndodhjes, vendosjes, zhvendosjes së pronësisë ose të të drejtave të tjera që lidhen me pasurinë që është produkt i veprës penale, kryerjes së veprimeve financiare dhe transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi sipas ligjit për pastrimin e parave etj. Midis veprimeve të autorit të veprës penale (që synon pastrimin e produktit të veprës penale) dhe pasojës apo mundësisë së ardhjes së saj (pastrimi i produktit të veprës penale) duhet të ekzistojë lidhja shkakësore e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme, që do të thotë se pastrimi i produktit të veprës penale (pasoja) duhet të vijë ekskluzivisht dhe drejtpërdrejtë nga veprimet e autorit të veprës penale (shkaku).

Subjekt i kesaj veprë penale është çdo person i cili ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm mëndërisht përpara ligjit ose subjekti i posaçëm i cili kryhen një veprimtari profesionale.

Nga ana subjektive vepra penale kryhet me dashje direkte.

Pastrimi i parave është një "proces" nëpërmjet të cilit të ardhurat e realizuara me mënyra të kundraligjshme si korrupsion, trafik droge, njerëzish etj investohen apo përdoren në/për veprimtari të ligjshme me qëllim fshehjen e origjinës së tyre. Ky proces përfshin një numër të madh aktivitetesh, qëllimi i vetëm i të cilave është fshehja e origjinës, vendndodhjes, lëvizjes të pasurive të cilat rrjedhin nga veprimtari të kundraligjshme dhe përpykja që burimi i tyre të duket se është i ligjshëm. Midis produktit të veprës penale (vepra penale mëmë) dhe veprës penale të pastrimit të këtij produkti (vepra penale bijë) duhet të ekzistojë gjithmonë një lidhje shkakësore e drejtpërdrejtë dhe e domosdoshme.

Por, duhet theksuar se vepra penale mëmë duhet të jetë e tillë që të gjenerojë të ardhura, pra, nga ajo personi duhet të ketë përfituar pasuri, product, pasi jo çdo vepër penale gjeneron të tilla.

Që personi të akuzohet e të dënohet për kryerjen e veprës penale "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, duhet që të plotësohen njekohesisht kushtet kumulative sa më poshte vijon:

- a. Të ketë dyshime të arsyeshme dhe më pas prova bindëse se vetë ky person, familjarët apo të afërmit e tij (nuk përjashtohen personat e njohur prej tij si shokë, miq, kolegë, ortakë etj) kryejnë veprimtari të jashteligjshme si psh: trafik droge, akte korruptive, trafik njerëzish etj nga e cila përfitohen të ardhura;
- b. Personi të disponojë pasuri të luajtshme apo të pa luajtshme të cilat nuk justifikohen nga të ardhurat e tij të cilat janë përfituar duke kryer një punë apo veprimtari të ligjshme, pra personi nuk justifikon pasurinë që

posedon pasi ajo nuk përputhet me ato që ai fiton në mënyrë të ligjshme (raporti midis fitimeve apo ardhurave (burimi i pasurisë/pasurive) është në përpjestim të zhdrejtë me pasurinë/pasuritë që disponohen). Për të pasur ekzistencën e elementeve të veprës së "Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale" duhet medoemos që pasuria e krijuar apo vlera monetare që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie të jetë rrjedhojë e përfitimeve të ardhura nga aktiviteti kriminal i kryer (vendimi nr.327 datë 5 Dhjetor 2012 i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë).

c. Të ardhurat e përfituara nga kryerja e veprimtarive të jashtëligjshme të jenë përdorur apo përdoren në/për veprimtari të ligjshme me qëllim fshehjen e origjinës së tyre.

3. Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera, rezulton se në rastin objekt hetimi, pretendimi i Prokurorit se "fakti për të cilin akuzohet i pandehuri nuk parashikohet nga ligji si veper penale", është rrjedhojë e një hetimit të plote e shterues.

4. Duke analizuar veprimet e Prokurorit për hetimin e çështjes, konstatohet fakti se Prokurori ka zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata në vendimin e saj numer 523(1417), datë 07.05.2020. Prokuroria e rrethit Shkoder ka urdheruar e ka kryer ekspertimet "Kontabel" e "Vlersues", duke respektuar kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara në nenet 34/a/1, shkronjat "ë", "f" e "g"; 50/2 dhe 179 të Kodit të Procedurës Penale.

5. Konstatohet se Prokuroria e Rrethit Shkoder, me vendim "Për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit vlersues të mjeteve", ka vendosë kryerjen e ekspertimit vlersues të mjeteve: "Porsche Panamera", prodhim i vitit 2012, me targë AA [redacted], "Peugot 407", prodhim i vitit 2007, me targë AA [redacted], "Ferrari Lj 65 California", prodhim i vitit 2009, me targë AA [redacted] dhe "Land Rover Free Lander", prodhim i vitit 2005, me targë AA [redacted], duke caktuar për këto qëllim si ekspert shtetasin [redacted].

6. Konstatohet se Prokuroria e Rrethit Shkoder, me vendimin "Për caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit Kontabel" ka vendosë kryerjen e ekspertimit kontabel, për të percaktuar sa janë të ardhurat e ligjshme të shtetasit Kacjlon Zefi për të percaktuar vlerën në automjeteve në pronësi të këtij shtetasi dhe për të percaktuar nëse përputhet vlera e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme e zotëruar nga shtetasi Kacjlon Zefi me të ardhurat e ligjshme, duke caktuar për këto qëllim si ekspert shtetasin [redacted]. Provohet se shtetasit [redacted] X [redacted] e [redacted] N [redacted] të caktuar si ekspertë nga ana e Prokurorit, kanë njohuritë e duhura e janë ekspertë të licencuar nga organet kompetente shtetërore.

7. Sipas aktit të ekspertimit të titulluar "Akt vlersimi i mjeteve", hartuar nga eksperti vlersues [redacted] X [redacted], provohet se:

-Vlera e tregut e mjetit të markes "Porsche Panamera", prodhim i vitit 2012, me targë AA [redacted], është 861.000 lek.

-Vlera e tregut e mjetit të markes "Peugot 407", prodhim i vitit 2007, me targë AA [redacted], është 221.400 lek.

-Vlera e tregut e mjetit të markes "Ferrari Lj 65 California", prodhim i vitit 2009, me targë AA [redacted], është 3.997.500 lek.

-Vlera e tregut e mjetit të markes "Land Rover Free Lander", prodhim i vitit 2005, me targë AA [redacted], është 396.800 lek.

8. Sipas aktit të ekspertimit të titulluar "Raport i ekspertit kontabel" hartuar nga Audituesi ligjorë, eksperti [redacted] N [redacted] me datë 06.06.2020, provohet se:

-Të ardhurat e ligjshme të shtetasit Kacjlon Zefi janë në shumën prej 9.862.822 lek.

-Vlera e pasurive të luajtshme të shtetasit Kacjlon Zefi (e automjeteve në pronësi të këtij shtetasi) është 9.446.695 lek.



- Perputhet vlera e pasurise se luajteshme e zoteruar nga shtetasi K. Z. me te ardhurat e ligjeshme te ardhurat e ligjeshme te ketij shtetasi jane ne shumen 9.862.822 lek ndersa vlera e pasurise se luajteshme zoteruar nga ky shtetas eshte ne shumen prej 9.446.695 lek.
- Te ardhurat e ligjeshme dalin me teprice ne vleren prej 416.127 lek.

Nga aktet dhe provat e administruara ne dosjen e ketij procedimi penal,nuk provohet se nga shtetasi K. Z. te jene konsumuar elementet e figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”,parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Vertetë shtetasi K. Z. me vendimin penal numer 73 date 25.06.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë,vendim ky i lene ne fuqi nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda,Tiranë me vendimin numer 77,date 19.10.2018,është deklaruar fajtor e denuar me 6(gjashtë) vjet e 8(tetë)muaj burgim per kryerjen e vepres penale“Trafikimi i narkotikëve”,mbetur në tentativë,parashikuar nga neni 283/a dhe 22 i Kodit Penal,por gjithashtu rezulton e provuar se shtetasi K. Z. perpara se te denohej ka qene i punesuar e ka siguruar te ardhura te ligjshme si ne Itali ashtu dhe Shqiperi.

Rezulton provuar se ai perpara se te denohej,ai ka siguruar 9.862.822 lek te ardhura te ligjeshme,ndersa pasuria e luajteshme e regjistruar ne emer te tij eshte ne shumen prej 9.446.695 lek.

Sipas aktit te ekspertimit kontabel,te ardhurat e ligjeshme dalin me teprice ne vleren prej 416.127 lek. Pra,nuk rezulton te ketë një disproporcion midis të ardhurave të shtetasit K. Z. dhe pasurive te luatteshme që janë në pronësi apo posedim të tij.Për më tepër ato rezultojnë të jenë vënë përpara se shtetasi K. Z. të arrestohej e denohej për kryerjen e veprës penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 283/2 i Kodit Penal .

Nga te dhenat e vena në dispozicion nga bankat e nivelit të dytë që ushtrojnë veprimtarinë tyre në Republikën e Shqipërisë si dhe agjensitë e transferimit të parave rezulton se shtetasi K. Z. dhe familjarët e tij nuk kanë transaksione nga persona të dyshimtë brenda apo jashtë vëndit.

Nuk konstatohet se shtetasi K. Z. apo antarët e familjes së tij te kene kryer transaksione të dyshimta me pasuri të luajteshme apo të pa luajteshme me qëllim fshehjen e origjinës së tyre si psh:transferimi tek personat e tretë nëpërmjet shitjes apo dhurimit.

Shtetasi K. Z. te afermit e tij,disponojë pasuri të luajteshme e të pa luajteshme të cilat justifikohen nga të ardhurat e ssiguruara nder vite,të cilat janë përfituar duke kryer një punë apo veprimtari të ligjshme,ai e justifikon pasurinë që posedon,kjo pasuri përputhet me ato që ai ka fituar në mënyrë të ligjshme (raporti midis fitimeve apo të ardhurave(burimi i pasurisë/pasurive) është në përpjestim të drejtë me pasurinë/pasuritë që disponohen).

Për të pasur ekzistencën e elementeve të veprës së “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”,duhet medoemos që pasuria e krijuar apo vlera monetare që ka shërbyer për krijimin e kësaj pasurie të jetë rrjedhojë e përfitimeve të ardhura nga aktiviteti kriminal i kryer,gjë qe nuk povohet per ketë shtetas.Nuk provohet qe ky shtetas te ketë perfituar te ardhura nga kryerja e veprimtarive të jashtëligjshme e as nuk provohet qe të ketë te ardhura qe te jenë përdorur apo përdoren prej tij në/për veprimtari të ligjshme me qëllim fshehjen e origjinës së tyre.

Gjykata vlerson se nga ana e Prokurorise jane zhvilluar hetime te plota e shteruese,janë sqaruar plotësisht rrethanat çështjes dhe rezulton se nuk ndodhemi para konsumimit të elementëve të vepres penale “Pastrimi

i produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale”,parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal apo ndonjë veprë tjetër penale të parashikuar nga Kodi Penal,nga i pandehuri ~~Ka~~ ~~Z~~ Trupi gjykues vlen te theksoje faktin se Kodi Penal i Republikes se Shqiperise bazohet në parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës,të barazisë përpara ligjit,të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe të dënimit, si dhe të humanizmit.

Ndersa ne nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale është sanksionuar se:“I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë.Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit”.

Parimi i prezumimit të pafajësisë përbëhet nga disa aspekte,njëri prej të cilëve është se çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Ky parim është trajtuar hollësisht nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë si dhe nga Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut. *Vendimet nr.9 datë 28 Prill 2004 dhe nr. 23 datë 23 Korrik 2009 te Gjykatës Kushtetuese.*

Nga shqyrtimi i fakteve dhe analiza e provave të administruara në dosjen e këtij procedimi penal nuk provohet tej çdo dyshimi të arsyeshëm se nga shtetasi ~~Ka~~ ~~Z~~ te jenë konsumuar elementët e figurës së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”,parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Prandaj bazuar ne nenin 329/b/3 të K.Pr.Penale,Gjykata duke çmuar se jemi ne kushtet e parashikuara ne nenin 328/1,shkronja “b” te Kodit te Procedures Penale,vendos te pronoje kerkesen e Prokurorit per pushimin e procedimit penal numer 194 te vitit 2017,regjistruar me datë 12.02.2017 ne Prokurorine e Rrethit Shkoder ndaj shtetasit ~~Ka~~ ~~P~~ ~~Z~~ i akuzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”,veper kjo e parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal pasi del qartë dhe provohet se fakti per te cilin eshte regjistruar ky procedim penal per te cilin akuzohet shtetasi ~~Ka~~ ~~Z~~,nuk perben veper penale.

Po keshtu,per shkaqet e mesiperme,Gjykata bazuar ne nenin 190/1,shkronjat “a”,“b” e “ç” te Kodit te Procedures Penale,vlerson se provat materiale te sekuestruara per llogari te ketij procedimi,mbajtja e te cilave ndalohet nga ligji,te konfiskohen e te kalojne ne favor te shtetit,ndersa provat materiale te sekuestruara per llogari te ketij procedimi,mbajtja e te cilave nuk ndalohet nga ligji,t’i kthehen personit qe i takojnë.

PER KETO ARSYE

Trupi gjykues bazuar ne nenet:328/1,shkronja “b” dhe 329/b/3 te Kodit Procedures Penale.

VENDOSI:

1.Pranimin e kerkeses se Prokurorit.

2.Pushimin e procedimit penal numer 194,regjistruar më datë 12.07.2017 ne Prokurorin e Rrethit Shkoder, ndaj shtetasit ~~Ka~~ ~~P~~ ~~Z~~,i akuzuar për veprën penale “Pastrimi i produkteve të vepres penale ose veprimtarisë kriminale”,parashikuar nga neni 287/1 i Kodit Penal,pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si veper penale.

3.Bazuar ne nenin 190/1,shkronjat “a” e “b” te Kodit te Procedures Penale,provat materiale te sekuestruara per llogari te ketij procedimi,mbajtja e te cilave ndalohet nga ligji,te konfiskohen e te kalojne ne favor te shtetit.

4.Bazuar ne nenin 190/1,shkronja “ç” te Kodit te Procedures Penale,provat materiale te sekuestruara per llogari te ketij procedimi,mbajtja e te cilave nuk ndalohet nga ligji,t’i kthehen personit qe i takojnë.



- Shpenzimet gjyqesore dhe ato procedurale te kryera gjate hetimeve paraprake siç jane berë.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim brenda 15 diteve,duke filluar nga e nesermja e shpalljes,ne Gjykatën e Apelit Shkoder .
- Per Prokurorin ne mungesë,ky afat fillon nga e nesermja e ardhjes ne dijani te ketij vendimi.
- Ky vendim u shpall ne Shkoder,ne prani avokatit mbrojtës te pandehurit,sot me datë 29.09.2020.

**SEKRETARE
FLORINDA GEGA**

**GJYQTAR
TONIN STERKAJ**

REKORDI I DOKUMENTIT
ME DATË 27/11/2020

